



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

UDHËZUES

PËR

PËR BASHKËPUNIMIN ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE
NË MINISTRINË E MBROJTJES DHE
FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes

Nr. 130, datë 31.1.2024

I. HYRJE

Shoqëria civile dhe organizatat e shoqërisë civile në Republikën e Shqipërisë janë pjesë e demokracisë pjesëmarrëse dhe paraqesin një nga shtyllat kryesore të funksionimit të një shoqërie demokratike. Roli i aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile dhe pjesëmarrja e tyre në procese publike për çështjet që i përkasin fushës së Mbrojtjes konsiderohen mjaft të rëndësishme në monitorimin dhe kontributin ndaj transparencës së institucionit, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave nga Ministria e Mbrojtjes (MM), kanalizimin e pikëpamjeve të ndryshme, si dhe prezantimin e interesave të shoqërisë te vendimmarrësit.

II. KONTEKSTI

Ky dokument artikulon se si Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet mekanizmave të ndërveprimit ofron një qasje gjithëpërfshirëse drejt marrëdhënieve reciprokisht të dobishme dhe novatore, të bazuara në besim, vizion të përbashkët dhe përkushtim ndaj objektivave të përbashkëta me aktorët e shoqërisë civile.

Ky dokument rrit përpjekjet e Ministrisë së Mbrojtjes për të ndjekur vizionin e saj drejt një ridimensionimi në mënyrë më efektive të rolit dhe misionit të saj në një shoqëri globale dhe në ndryshim, dhe përmes partneritetit më aktorët civilë të rrisë efikasitetin, efektivitetin, ekspertizën, të ndajë njojuritë, përfitimet dhe rreziqet duke i dhënë mundësi çdo personi të marrë pjesë plotësisht dhe të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të një Force të Armatosur të modernizuar dhe me standarde.

Strategjia bazohet në parime dhe vlerat thelbësore të MM-së dhe mbështet parimet, angazhimin konstruktiv dhe konsensusin e krijuar në bashkëpunimin me institucionet e tjera, organizatat ndërkombëtare, si dhe mësimet e nxjerra dhe rekomandimet që vijnë veçanërisht nga perspektiva e shoqërisë civile.

III. MINISTRIA E MBROJTJES DHE MARRËDHËNIET AKTUALE ME SHOQËRINË CIVILE

Ministria e Mbrojtjes e konsideron bashkëpunimin me shoqërinë civile si një mjet të domosdoshëm në kuadër të përmirësimit të klimës së bashkëpunimit dhe pjesëmarrjen në forume të përbashkëta diskutimi, rritjen e mundësive konkrete të partneritetit, si dhe promovimin e praktikave më të mira në këtë drejtim.

1. Qëndrimi i MM-së për rëndësinë e rolit të shoqërisë civile në sektorin e mbrojtjes.

Hartimi nga MM-ja i një dokumenti për bashkëpunim mbi bazat e partneritetit do t'i shërbejë interesit të përbashkët të ngritjes së kapaciteteve të komunikimit të rregullt dhe të strukturuar në funksion të hartimit të politikave të qëndrueshme publike, rritjes të llogaridhënieve dhe transparencës, me qëllim për të forcuar arkitekturën e mbikëqyrjes së mbrojtjes së vendit.

MM-ja beson se ndërtimi i një marrëdhënie partneriteti me shoqërinë civile dhe një aleance efektive me përfitim të ndërsjellë me komunitetin është absolutisht thelbësore dhe duhet të ndërtohet mbi besimin dhe dialogun dhe të zhvillohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke sjellë qytetarët dhe veçanërisht organizatat e shoqërisë civile jo vetëm më pranë procesit të vendimmarrjes në MM, por gjithashtu të kontribuojnë në përmirësimin e besueshmërisë ndaj politikave të MM-së.

2. Plani i angazhimit dhe qëllimi.

Ky dokument përfshin objektivat dhe masat strategjike të hartuara nga MM-ja, si dhe një plan specifik të veprimit dhe monitorimit për këtë proces me ndarje të përgjegjësive. Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara për vitin 2024 do të drejtohen nga MM/SHPFA, në bashkëpunim dhe koordinim me përfaqësues të shoqërisë civile.

MM-ja përmes ekspertizës ka dizajnuar një sistem gjithëpërfshirës së monitorimit të strategjisë së bashkëpunimit me shoqërinë civile, nëpërmjet përgatitjes së raporteve të rregullta gjashtë-mujore dhe vjetore mbi matjen e çfarëdo niveli të rezultatit të zbatimit të strategjisë.

MM-ja ka identifikuar disa përpjekje për të përmirësuar proceset e dialogut civil si përbërës thelbësor të demokracisë pjesëmarrëse, që do të shërbejnë si katalizator për cilësinë dhe efektshmérinë e bashkëpunimit dhe mundësojnë një progres në hapjen e proceseve për konsultim, informim, dialog, partneritet dhe ndërtimin e infrastrukturës për pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e politikave, ligjeve, planeve të veprimit dhe strategjive të Mbrojtjes.

3. Parimet e planit.

Hapat pozitivë të ndërmarra nga MM-ja përfshijnë planifikimin e masave konkrete për mundësimin e hapësirës për dialog dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për pjesëmarrje, të cilat pasqyrojnë angazhimet specifike të shoqërisë civile në kuadrin e planeve dhe politikave kombëtare të veprimit.

MM-ja është plotësisht e hapur dhe e gatshme për të përfshirë ngushtësisht në planet dhe projektet e zhvillimit të gjithë aktorët e shoqërisë civile dhe palët e interesuara për partneritet dhe dialog. Këto përpjekje përfshijnë përmirësimin e kuadrit ligjor gjatë hartimit dhe zbatimit të legjislacionit që mund t'i prekë këto organizata, si dhe thjeshtëzimin e procedurave për organizimin e konsultimeve publike.

IV. FUSHAT E ANGAZHIMIT

1. Angazhimi konstruktiv.

MM-ja ofron angazhim konstruktiv si një qasje për ndryshim dhe transformim që kërkon ndërveprim të dyanshëm dhe një marrëdhënie reciproke ndërmjet shoqërisë civile dhe MM-së, që u mundëson qytetarëve përfaqësim, akses dhe angazhim konstruktiv në vendimmarrje, për të shprehur qëndrimet dhe perspektivat për rolet e njëra-tjetrës në zgjidhjet e zhvillimit dhe inovacionin, modernizimin dhe zhvillimin e politikave demokratike, bazuar në respektin reciprok, besimin, legitimitetin, përgjegjshmérinë, transparencën dhe kompetencën.

Ky vizion ilustron veçanërisht përpjekjet dhe gatishmërinë e MM-së për promovimin dhe ndërtimin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të suksesshme të kapaciteteve institucionale dhe strukturore përmes lidhjeve dhe bashkëpunimit duke koordinuar mjaftueshëm koalicionë komplekse qytetare si në nivel kombëtar ashtu edhe institucional.

V. KONSULTIMI PUBLIK NË MM

MM-ja vijon të mbështesë nismën e qeverisë përfshirjen e shoqërisë civile, grupeve të interesit apo palët e interesuara për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të MM-së. Konsultimi publik në MM synon promovimin e një

qasjeje të integruar dhe implementimin e një sistemi transparent dhe llogaridhënës, duke u konsultuar ngushtë me të gjithë partnerët relevant të fushës dhe duke adresuar në mënyrë specifike çështjet e marrëdhënieve mes të shoqërisë civile dhe politikëbërjes.

Procesi i konsultimit publik e angazhon MM-në të zbatojë me përpikëri standartet dhe kërkesat e Strategjisë Kombëtare për Konsultimin Publik, dhe përfshin krijimin e një platforme online të konsultimit publik, si dhe përgatitjen e planeve të punës dhe projekteve fillestare të bashkëpunimit, koordinimin, organizimin dhe zhvillimin e takimeve mbështetur në priorititet e MM-së, duke i mundësuar qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, bizneseve apo grupeve të tjera të interesit diskutimet e para konstruktive dhe të frytshme pa filluar shkrimin e drafteve të ligjeve a politikave, si dhe dërgimin e rekomandimeve/opinioneve/komenteve të tyre me shkrim.

1. Qëllimi i procesit të konsultimit publik në MM.

Qëllimi kryesor i strategjisë së MM-së për bashkëpunimin me shoqërinë civile është t'i sigurojë MM-së një kornizë për angazhimin e shoqërisë civile në procesin e zhvillimit të prioritetave strategjike. Ky dokument thekson rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit nëpërmjet partneriteteve, ndikimin në rritje të shoqërisë civile në suksesin dhe qëndrueshmérinë e MM-së, mbështet dialogun, ndihmën e ndërsjellë, maksimizon angazhimin dhe ndikimin e aktorëve të shoqërisë, grupeve të ndryshme dhe palëve të interesuara, të cilat, nëpërmjet konsensusit të krijuar, do të kontribuojnë dhe do të mbështesin aspiratat dhe objektivat afatgjatë të MM-së.

Mbledhja e rekomandimeve dhe komenteve nga qytetarët, publiku i gjerë, shoqëria civile, akademikët, biznesi, partnerët për zhvillim do të kontribuojë për të zgjidhur sfidat e përbashkëta në fushën e mbrojtjes.

2. Objektivat strategjikë të konsultimit publik në MM.

Objektivat strategjikë të MM-së në procesin e konsultimit publik synojnë përmirësimin e kornizës institucionale dhe ligjore për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në projektet dhe programet me interes publik, të cilat përcaktohen qartë në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

VI. BASHKËPUNIMI CIVILO-USHTARAK

Bashkëpunimi civilo-ushtarak konsiderohet si elementi thelbësor në bashkërendimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Forcave të Armatosura me shoqërinë civile, autoritetet vendore, subjektit civil, komunitetin, agjencitë dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare, në mbështetje të zbatimit të objektivave të FA-së dhe të kryerjes së misioneve dhe operacioneve, brenda dhe jashtë vendit.

Bashkëpunimi civilo-ushtarak ka si prioritet krijimin e një kuptimi të përbashkët të parimeve dhe vlerave të konceptit të ndërveprimit, të lehtesojë dhe të koordinojë shkëmbimin e informacionit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare, organizatave joqeveritare, me qëllim për të përmirësuar implementimin e projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit civilo-ushtarak.

VII. DIALOGU DHE KONSULTIMI POLITIK NË HARTIMIN E POLITIKAVE TË MBROJTJES

Shoqëria civile ka rol të rëndësishëm *në* hartimin dhe zbatimin e politikave të Mbrojtjes. MM-ja është e angazhuar *në* mbështetjen e shoqërisë civile dhe nismën për ndërtimin dhe zbatimin e modelit të politikave konstruktive, përmes dialogut dhe debatit konstruktiv që mundëson përfaqësimin dhe shprehjen e organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, për politika mbrojtjeje që janë të rëndësishë thelbësore dhe prekin të gjithë qytetarët *në* shoqëri.

Ky bashkëpunim përfshin të gjithë aktorët e shoqërisë civile, autoritetet vendore, subjektet civile, komunitetin, agjencitë dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare *në* një proces mjaft të rëndësishëm që ka *në* qendër pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë *në* proceset e konsultimit të legjislacionit, monitorimit të punës dhe veprimeve konkrete, performancën e MM-së, duke luajtur një rol kyç *në* monitorimin, konsultimin dhe vlerësimin e veprimeve, rekomandimeve dhe masave *në* përputhje me angazhimet kombëtare.

VIII. KOMUNIKIMI STRATEGJIK

Komunikimi strategjik *në* vitet e fundit ka demonstruar qartë një fuqi *në* rritje *në* arenën publike dhe qeveritare, si dhe rolin e jashtëzakonshëm që përfshin linja përpjekjesh dhe teknikash, me qëllim ndjekjen e objektivave politikë dhe ushtarakë për të arritur një qëllim të caktuar *në* fushën e mbrojtjes.

Komunikimi efektiv duhet të bazohet gjithashtu mbi të kuptuarit e shoqërisë civile dhe fuqinë e veprimit për ndikuar drejtpërdrejt *në* perceptimet e shoqërisë civile, organizatave të ndryshme, komunitetit apo individëve të caktuar, me qëllim ridimensionimin e qëndrimeve publike brenda vendit, si dhe të pasqyrojë nevojat për informim të publikut. Ky dokument afatgjatë komunikimi bazohet *në* parimet e të qenit të hapur, transparencës dhe partneritetit me shoqërinë civile.

IX. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Në kushtet e zhvillimeve aktuale shoqërore, politike dhe kulturore, teknologjitet e informacionit dhe komunikimit kanë krijuar mundësi të shumta bashkëpunimi dhe koordinimi midis MM-së dhe shoqërisë civile, duke sjellë kështu një rritje të konsiderueshme të veprimtarisë online të shoqërisë civile, organizatave të ndryshme, si dhe individëve që të trajtojnë së bashku sfidat shoqërore dhe veçanërisht *në* fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit *në* MM ka si qëllim t'i mundësojë qytetarëve, medias dhe organizatave të shoqërisë civile që të adresojnë kërkesat e tyre për informacion, angazhimin dhe pjesëmarrjen e publikut gjatë proceseve të konsultimit publik me grupet e interesit gjatë hartimit të ligjeve dhe politikave të tjera me interes të lartë publik, përmirësimin e komunikimit ndërpyetar, transparencën, efikasitetin, llogaridhënen dhe besueshmërinë *ndaj* institucionit të MM-së, shpërndarje më të gjerë e më të lehtë të informacionit me karakter publik.